

VENDIM
Nr. 339, datë 6.6.2018

**PËR KRITERET DHE MËNYRËN E NDARJES SË ÇMIMIT “AMBASADOR
I KOMBIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kriterëve dhe të mënyrës së ndarjes të çmimit “Ambasador i Kombit”.
 2. Ndarja e çmimit “Ambasador i Kombit” udhëhiqet nga parimet e vlerësimit të kontributit, meritokracisë, transparencës, mirënjohjes publike. Kriteret, që duhet të plotësojnë pjesëtarët e suksesshëm të diasporës për marrjen e çmimit, janë:
 - a) Integriteti dhe reputacioni në komunitetin ku ai/ajo jeton;
 - b) Përfaqësimi i suksesshëm në diasporë në:
 - veprimtari humanitare;
 - arsim, shkencë, teknologji;
 - kulturë apo sport;
 - biznes.
 - c) Kontributi i veçantë për Republikën e Shqipërisë apo diasporën.
 3. Ambasadorët e Republikës së Shqipërisë, të akredituar jashtë vendit, nëpërmjet ministrit përgjegjës për punët e jashtme, i propozojnë ministrit përgjegjës për diasporën përfaqësuesit më të suksesshëm të komuniteteve shqiptare jashtë vendit për dhënien e çmimit “Ambasador i Kombit”.
 4. Propozimet duhet të shoqërohen me biografinë dhe vlerësime të nevojshme të veprimtarisë së subjektit të propozuar.
 5. Ministri përgjegjës për diasporën vlerëson propozimet e ardhura, së bashku me rekomandimet për dhënien e çmimit, dhe ia propozon ato, zyrtarisht, Kryeministrit.
 6. Çmimi “Ambasador i Kombit” jepet nga Kryeministri.
 7. Çmimi “Ambasador i Kombit” i dorëzohet personalisht personit që merr çmimin, por, në raste të veçanta, mund t’i dorëzohet edhe familjarëve apo përfaqësuesve të tij.
 8. Çmimi “Ambasador i Kombit” nuk ka vlerë monetare.
 9. Çmimi “Ambasador i Kombit” jepet në formën e një certifikate.
 10. Forma e certifikatës “Ambasador i Kombit” është sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi.
 11. Përjashtimisht, për raste të veçanta, propozimi për çmimin “Ambasador i Kombit” mund të bëhet drejtpërdrejt nga ministri përgjegjës për diasporën, në përputhje me këtë vendim dhe, në këtë rast, nuk do të zbatohet parashikimi i pikës 3.
 12. Ngarkohen ministri përgjegjës për diasporën, ministri përgjegjës për punët e jashtme dhe Agjencia Kombëtare për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi



T'a disk dhe të jesh i sigurtë, se falbardhësia dhe luntanija jete gjindet në Shqipëri e cila t'op nder dhe të fal emrin shqiptar.

Rugje mirë karakterin komtar dhe kryenallësinë shqiptare; bingju ligjend dhe urdhruvet të vendit kudo që të jesh.

Qdo shqiptar është ulla Ull; nderoje kurdohërë dhe ndihmoje kur të ketë nevojë.

Mos e përbuz gjuhën e nonës s'atë tue fole në gjuhë të huaj kur nuk asht nevojë.

Ndoro flamurin e atdheut tand; kush nuk e nderon shqjën e kansisë shnderon veldën e vet.

Dashunija për atdhe ndihet ma tepër në mërgim, prandaj këtë dashuni ruaje edhe kur të kthehesh në vendin t'and.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AMBASADORI I KOMBIT

Emër Mbiemër

KRYEMINISTRI

MINISTRI

